



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 gusht 2022  
Nr. Ref.:RK 2032/22

**AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**  
në

**rastin nr. KI54/22**

Parashtrues

**Nexhmi Uka**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së  
Aktvendimit PPC. nr. 4/2015 të 10 dhjetorit 2015  
të Gjykatës Supreme të Kosovës**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

**Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Nexhmi Uka, nga fshati Kalaticë i komunës së Podujevës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Mentor Bogaj, avokat në Prishtinë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [PPC. nr. 4/2015] e 10 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktvendimin [CA. nr. 2703/2013] e 2 tetorit 2015 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] të Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 856/09] dhe Aktgjykimin [C. nr. 306/08] e 18 majit 2009 të Gjykatës Komunale në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale).
3. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar në vitin 2016.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] lidhur me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 27 prill 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 6 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI54/22] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 12 maj 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 3 qershor 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
10. Më 16 qershor 2022, Gjykata Themelore e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar vendimin e kontestuar.

11. Më 19 korrik 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurën para gjykatave të rregullta**

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit të kërkesës, menaxher i restoranteve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës përmes Vendimit [nr. 2942/065] të 30 tetorit 2008 të Drejtorit Menaxhues të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës duke filluar nga 1 nëntori 2008.
13. Më 9 dhjetor 2008, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale për anulimin e vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kundër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, me propozimin që Gjykata Themelore të aprovojë kërkesëpadinë, të detyrojë të paditurin ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës.
14. Më 18 maj 2009, Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit [C. nr. 306/08] e aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e anuloi Vendimin [nr. 2942/065] të 30 tetorit 2008, si të kundërligjshëm.
15. Më 29 qershor 2009, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kundër Aktgjykimit [C. nr. 306/08] të 18 majit 2009 të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 6 tetor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 856/09] refuzoi si të pabazuar ankesën e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 306/2008] e Gjykatës Komunale të 18 majit 2009.
17. Më 10 nëntor 2009, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Qarkut, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të dispozitave materiale.
18. Më 17 mars 2010, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 524/2009] aprovoi si të bazuar revizionin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 306/08] e Gjykatës Komunale dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 856/09] e Gjykatës së Qarkut, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.

### **Përmbledhja e fakteve në procedurë përmbarimore**

19. Nga shkresat e lëndës rezulton se pas nxjerrjes së Aktgjykimit [Ac. nr. 856/09] të Gjykatës së Qarkut ishte iniciuar procedura e përmbarimit në Gjykatën Komunale, në favor të parashtruesit të kërkesës. Kjo procedurë përmbarimore u pezullua më 21 prill 2010, përmes Aktvendimit [E. nr. 1065/2009] të Gjykatës Komunale, për shkak të prishjes së titullit ekzekutiv me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] e Gjykatës Supreme të 17 marsit 2010. Duke iu referuar Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, në arsyetimin e Aktvendimit të saj Gjykata Komunale theksoi se “... gjykata pas shqyrtimit të rrethanave të më sipërcituar sipas detyrës zyrtare pezulloi procedurën përmbarimore që udhëhiqet në këtë gjykatë me

*numër E. nr. 1067/2010 si dhe duke i abroguar të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në këtë lëndë”.*

### **Përmbledhja e fakteve sa i përket përsëritjes së procedurës**

20. Më 15 prill 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Qarkut propozim për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] e Gjykatës Supreme të 17 marsit 2010, si rezultat i zbatimit të gabuar të nenit 11 të Ligjit Themelor të Punës dhe mungesës së kontratës së punës në shkresat e lëndës.
21. Më 1 korrik 2013, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AC. nr. 5331/2012] e refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] të Gjykatës Supreme të 17 marsit 2010.
22. Më 2 tetor 2015, Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës dhe detyrës zyrtare, përmes Aktvendimit [CA. nr. 2703/2013] prishi Aktvendimin [AC. nr. 5331/2012] e Gjykatës së Apelit të 1 korrikut 2013 dhe i dorëzoi lëndën Gjykatës Supreme si gjykatë me kompetencë lëndore për vendosje sipas propozimit të ushtruar për përsëritjen e procedurës.
23. Më 10 dhjetor 2015, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PPC. nr. 4/2015] refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] të Gjykatës Supreme të 17 marsit 2010, si rezultat i mosplotësimit të kushteve ligjore dhe faktit se kontrata e punës nuk ndikonte në marrjen e një vendimi ndryshe nga ai i Gjykatës Supreme në procedurën e revizionit.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] lidhur me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009], duke vendosur sipas revizionit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, me të cilin prishi vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, nuk ka ofruar arsyetim të duhur dhe bindës dhe se nuk i ka pasur në shkresat e lëndës provat vendimtare që kanë çuar në marrjen e vendimit në dëm të tij. Tutje, parashtruesi i kërkesës shton se Gjykata Supreme nuk ka shfrytëzuar mundësinë për të përmirësuar gabimin e saj, ndonëse kishte fakte dhe prova të mjaftueshme, kur përmes Aktvendimit [PPC. nr. 4/2015] të Gjykatës Supreme të 10 dhjetorit 2015 e refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] e Gjykatës Supreme të 17 marsit 2010.
26. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se me kontratën e tij të punës për kohë të pacaktuar nuk ishte paraparë mundësia e shkëputjes së njëanshme të kontratës nga punëdhënësi.
27. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Aktvendimin [PPC. nr. 4/2015] e Gjykatës Supreme të 10 dhjetorit 2015 lidhur me përsëritjen e procedurës e ka pranuar më 27 janar 2022. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se aktvendimi i kontestuar nuk i

është dorëzuar atij apo përfaqësuesit të tij dhe se gjithnjë i ishte thënë se ende nuk është vendosur lidhur me kërkesën e tij.

28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të i) deklarojë kërkesën të pranueshme; ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës lidhur me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së dhe të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] lidhur me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; iii) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [PPC. nr. 4/2015] të 10 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme; iv) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] të 17 marsit 2010 të Gjykatës Supreme; v) të urdhërojë përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin [Rev. nr. 524/2009] e Gjykatës Supreme të 17 marsit 2010; dhe vi) sipas mundësisë, të aplikojë nenin 50 të Ligjit për kthim në gjendjen e mëparshme.

### **Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës**

#### **Ligji**

##### **Neni 49 (Afatet)**

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.*

#### **Rregullorja e punës**

##### **Rregulli 39 (Kriteret e pranueshmërisë)**

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”*

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

29. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 të po të njëjtit nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritetet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.



30. Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale), çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [PPC. nr. 4/2015] e 10 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
32. Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se sipas nenit 49 (Afatet) të Ligjit, kërkesa duhet parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Kjo kërkesë është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
33. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [PPC. nr. 4/2015] e 10 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme. Fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Gjykata Themelore në Prishtinë - dega Lipjan, vërteton që avokati i parashtruesit të kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar në vitin 2016. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se çfarëdo veprimi procedural apo mosveprim i avokatit apo përfaqësuesit i atribuohet parashtruesit të kërkesës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Bekauri kundër Gjeorgjisë*, nr. 14102/02, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafët 22-25; *Migliore dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 58511/13, Vendim i 27 janarit 2014).
34. Parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e tij në Gjykatë më 27 prill 2022, 6 (gjashtë) vite pas pranimit të aktit të kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht është e papranueshme për shqyrtim.
35. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që kopja e vendimit të plotfuqishëm të organeve gjyqësore vendase t'i dorëzohet në mënyrë automatike, qëllimit dhe synimit të nenit 49 të Ligjit më së miri do t'i shërbejë nëse afati katërmujor llogaritet nga data kur është dorëzuar kopja e atij vendimi (shih, rastin GJEDNJ-së, *Worm kundër Austrisë*, nr. 83/1996/702/894, Aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33).
36. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, rastet e Gjykatës KI48/21, parashtrues *Xhavit R. Sadrija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 qershorit 2021, paragrafi 44; KI45/21, parashtrues *Samedin Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 majit 2021, paragrafi 35; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së, *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 10865/09,45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 17 shtatorit 2014, paragrafi 258).
37. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të

Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 19 korrik 2022, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani